



Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_ . \_\_ .2023

Lënda: Mbi kërkesën për informacion

## **Z. GENTI ÇANI**

**Tiranë**

Në përgjigje të kërkesës suaj, të datës 21.09.2023, përmes së cilës, referuar ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, keni kërkuar informacion mbi statusin e pozicionit “Drejtor i Drejtorisë së Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, nga data 1 tetor 2020 e në vijim, si dhe mbas hyrjes në fuqi të strukturës së miratuar me Vendimin nr. 355 datë 26.05.2023, ju bëjmë me dije, si më poshtë vijon:

*Për pikën e parë*, nga të dhënat tona, rezulton se, bazuar në Vendimin nr. 2, datë 8.01.2018 “Për disa ndryshime në Vendimin e datës nr.921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, të ndryshuar, në kuadër të procesit të ristrukturimit, ju jeni transferuar në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Në vijim, referuar kërkesës suaj për pezullim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me shkresën nr. 19353 prot., datë 2.11.2022, ka përcjellë vendimin për miratimin e pezullimit nga shërbimi civil për një periudhë 2 vjeçare.

Për sa më sipër, për periudhën 1 tetor 2020 e në vijim, rezultoni të jeni i emëruar në pozicionin e sipërcituar deri në momentin që keni kërkuar pezullimin nga shërbimi civil. Departamenti i Administratës Publike (DAP), nuk administron asnjë akt tjetër emërimi me procedura konkurrimi, transferimi të përhershëm, si dhe vendim lirimi /largimi nga detyra për këtë pozicion pune.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, bazuar në nenin 48, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr.125, datë 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, nuk ka përcjellë pranë DAP, asnjë kërkesë për transferim të përkohshëm, për nevoja të institucionit, pranë këtij pozicioni.

Sjellim në vëmendjen tuaj se, për transferimet e përkohshme brenda administratës doganore, DAP nuk është njësi përgjegjëse, pasi referuar nenit 13, të ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2019, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, transferimi i përkohshëm, bëhet sipas parimeve dhe procedurave specifike të këtij Kodi, si dhe akteve nënligjore, të dala në bazë e zbatm të tij.

*Për pikën e dytë*, ju informojmë se, me Vendimin nr. 355, datë 26.05.2022 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për personelin e administratës doganore”, të ndryshuar, Drejtoria e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit, mbas ristrukturimit u nda në dy drejtori : Drejtoria e Informimit dhe Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit. Për pozicionet “Drejtor Drejtorie”, për këto dy drejtori, nuk administrojmë akt transferimi në kuadër të procesit të ristrukturimit, apo akt emërimi me procedura konkurrimi. Përsa i përket transferimeve të përkohshme, ashtu siç cituam më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk ka përcjellë asnjë kërkesë pranë DAP .

*Për pikën e tretë dhe të katërt*, ju bëjmë me dije se, nga të dhënat që administrojmë, sipas strukturës së miratuar me VKM nr. 355, datë 26.05.2022 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 921, datë 29.12.2014 “Për personelin e administratës doganore”, të ndryshuar, pozicionet “Drejtor Drejtorie”, që rezultojnë vakant për periudhën e kërkuar janë :

- *Drejtor i Drejtorisë së Informacionit;*
- *Drejtor i Drejtorisë së Analizës së Riskut dhe Monitorimit;*
- *Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit në Qendër;*
- *Drejtor i Drejtorisë së Kontrolleve të Akcizës;*

*Së fundmi*, referuar statusit të praktikave shkresore, të cilat keni cituar, sqarojmë se, DAP, në përgjigje të shkresave tuaja protokolluar me tonën nr. 2952 prot., datë 1.06.2023 dhe nr.2953/3 prot., datë 4.08.2023 mbi përfundimin e pezullimit, si dhe rikthimin në shërbimin civil, bazuar në nenin 56, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kreun II, të Vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimin civil”, i ndryshuar, me shkresën nr. 2952/1 prot., datë 14.06.2023, si dhe me shkresën nr. 2952/3 prot., datë 4.08.2023, i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të shprehet mbi mundësinë e sisemimit tuaj në një nga pozicionet vakante, ku plotësoni kriteret e përshkrimit të punës.

Bazuar në pikën 3, të nenit 85, të Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, DAP do të vijoje me shqyrtimin e mundësisë për rikthimin tuaj në shërbim civil, me administrimin e përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, institucion i cili keni pasur marrëdhënien në shërbimin civil.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

